

Aneksi 7

FTESË PËR OFERTË

Emri: Milieukontakt Shqipëri
Adresa: Rr. ‘Xhorxhi Martini’, Pall. Teuta Konstruksion,
Shk.3, Ap.8 Kodi Postar 1017, Tiranë, Shqipëri
E-mail: office@milieukontakt.org
Afati i dorëzimit të ofertës: 31 mars 2024

Milieukontakt Shqipëri po zbaton projektin “*Të rinjtë për një të ardhme të qëndrueshme*” në kuadër të Programit Rajonal për Demokracinë Vendore në Ballkanin Prendimor 2 (ReLOaD2), i cili financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), duke mbështetur bashkitë në zhvillimin e mekanizmave transparente të financimit për OSHC-të, në mënyrë që të përmirësojë ofrimin e shërbimeve për qytetarët në komunitetin lokal.

Kushtet për pjesëmarrje:

Të gjithë subjektet e interesuara duhet të dorëzojnë ofertën e tyre sikurse parashikohet në kushtet e përgjithshme dhe specifike të kësaj ftese deri më 31 mars 2024, në adresën e e-mailit: office@milieukontakt.org ose në adresën postare Rr. ‘Xhorxhi Martini’, Pall. Teuta Konstruksion, Shk.3, Ap.8 Kodi Postar 1017, Tiranë, Shqipëri.

Specifikimet teknike:

Për këtë projekt, Milieukontakt Shqipëri do të zhvillojë procedurën e prokurimit për produktin sipas përshkrimeve në tabelën e mëposhtme.

Nr	Përshkrimi i produktit	Sasia	Çmimi/njësi Me TVSH (ALL)
1.	Pemë Bliri (Tilia Cordata Milla) 1.5-2m	50	
2.	Transport i pemëve	1	
	Totali		

Specifikime të përgjithshme teknike:

- Peme bliri (*Tilia Cordata Milla*), gjethegjerë lartesi 1,5 – 2 m, perimetri 15 – 20 cm (mosha 4-5 vjet), 50 cope
- Transport për pemët, 1 rrugë, pranë Shkollës 9 vjeçare “Skënder Libohova”, Lushnje
- Ofrimi i këtij shërbimi kërkohet për periudhën **Prill-Maj 2024**. Me Subjektin fitues do të lidhet nje kontrate.

Kushte të përgjithshme:

- 1) Subjektet duhet të jenë të regjistruar dhe licensuar rregullisht me objekt veprimtarie shërbimet e kërkuara;
- 2) Preferohen subjekte të regjistruar me aktivitet në territorin e bashkisë Lushnje;
- 3) Dorëzimi i ofertës do të bëhet vetëm nëpërmjet email office@milieukontakt.org brenda datës 31 mars 2024 ose në adresën postare Rr. ‘Xhorxhi Martini’, Pall. Teuta Konstruksion, Shk.3, Ap.8 Kodi Postar 1017, Tiranë, Shqipëri.
Nuk pranohen ofertat dorazi.
- 4) Pagesa e subjektit kryhet me transfertë bankare pas marrjes së shërbimit dhe lëshimit të faturës përkatëse.

Në ofertën e tij, ofertuesit duhet të paraqesë të dhënat e plota të personit të kontaktit. Gjithashtu ofertuesit, krahas Ofertës financiare të plotësuar, e cila duhet të jetë në ALL dhe TVSH të përfshihet në kosto/çmim, duhet të paraqesin edhe këto dokumenta:

- 1) Licencën për ushtrimin e aktivitetit / Ekstraktin e QKB te marre deri nje dite para postimit te ofertes;
- 2) Ofertën financiare për produktin sipas tabelës më sipër.
- 3) Numrin e llogarisë bankare.
- 4) Certificate origjine dhe fitosanitare për pemë.

Operatori që ofron shërbimin me çmimin më të ulët dhe në përputhje me specifikimet teknike sipas ftesës, do të njoftohet për të nënshkruar kontratën.